



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

URDHRI I FARMACISTËVE TË SHQIPËRISË

Nr. 1167 Prot, datë 10 / 06 / 2014

Nr. 329 Prot., datë 10 / 06 / 2014

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

NDËRMJET

**Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (referuar si KMDP)**, përfaqësuar nga Znj. FLORA ÇABEJ (POGAÇE), në bazë të tagrave që i jep Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;

**Dhe:**

**Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë (referuar si UFSH)** përfaqësuar nga Znj. DIANA TOMA, në bazë të tagrave që i jep Ligji Nr. 9150, Datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë",

UFSH dhe KMDP, referohen këtu e në vazhdim së bashku si Palët.

Palët me cilësinë që ju njeh ligji në Republikën e Shqipërisë dhe me vullnet të lirë, bien dakord të hartojnë dhe të nënshkruajnë këtë marrëveshje si më poshtë vijon:



## **Neni 1 Objekti**

Palët nënshkruese bien dakort të institucionalizojnë marrëdhëniet e tyre për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të tyre në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në përgjithësi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Për arritjen e këtij qëllimi bashkëpunimi i palëve do të realizohet mbi baza të njëjta dhe mbi parimin e reciprocitetit.

## **Neni 2 Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj marrëveshje është Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, ligji nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë çështjet që parashikohen në dispozitat e kësaj marrëveshje.

## **Neni 3 Mënyra e realizimit**

3.1. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë angazhohen që të bashkëpunojnë me njëri tjetrin në respekt dhe zbatim të kërkesave ligjore që burojnë nga Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Ligji 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë", ku në mënyrë të veçantë:

- a) KMDP dhe UFSH angazhohen të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informacioneve reciproke në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale gjatë ushtrimit të profesionit të farmacistit.
- b) KMDP i ofron bashkëpunim UFSH-së për hartimin e rregulloreve për sigurinë e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit, si dhe në rastet e pjesëmarrjes në grupe të përbashkëta pune për të dhënë mendime në hartimin e udhëzimeve të posaçme të palëve, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
- c) KMDP angazhohet të informojë UFSH-në për të gjitha detyrimet që ka në funksion të akteve ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.



- d) KMDP angazhohet të mbajë korrespondencë të vazhdueshme me një person kontakti të caktuar nga UFSH, i cili do të asistohet të kujdeset, ndihmojë dhe mbikëqyrë përpunimin e të dhënave personale në strukturat e saj, si dhe të ndjekë procesin e njoftimit pranë KMDP.
- e) UFSH do të asistojë KMDP nëpërmjet një liste elektronike, të përditësuar sa herë që është e mundur, vetëm me emrat e farmacistëve të regjistruar pranë saj, e shoqëruar me numrat e telefonit, adresat ku ushtrojnë profesionin kur është e mundur, me qëllim evidentimin e farmacistëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre si persona fizikë apo juridikë. KMDP angazhohet të ruajë konfidencialitetin mbi këtë informacion.
- f) Në ushtrim të çdo kompetence që i jep ligji nr.9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve ne Republikën e Shqipërisë”, UFSH, rast pas rasti, sa herë që është e mundur angazhohet t'i bëjë me dije farmacistëve detyrimin ligjor për të njoftuar pranë KMDP;

3.2 Palët angazhohen që të bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, që i shërbejnë zbatimit të ligjeve respektive.

3.3 Palët angazhohen që të kërkojnë mendimet dhe sugjerimet e palës tjetër në rast të nxjerrjes së rregulloreve, udhëzimeve apo amendimeve ligjore, që prekin objektin e palës tjetër.

#### **Neni 4 Koordinimi ndërmjet palëve**

- 4.1 Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
- 4.2 Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.
- 4.3 Komunikimi mes palëve do të jetë në formë shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.

#### **Neni 5 Amendimet**

Palët do të bëjnë amendime në këtë marrëveshje, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të paraqitur me shkrim.



**Neni 6**  
**Dispozitat e fundit**

6.1 Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin kjo Marrëveshje.

6.2 Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar. Kjo marrëveshje mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër.

6.3 Marrëveshja nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe dy të tjera pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë.

**PËR KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

**KOMISIONERI**

**Znj. Flora ÇABEJ (POGAÇE)**



**PËR URDHRIN E FARMACISTËVE TË SHQIPËRISË**

**PRESIDENTI**

**Znj. Diana TOMA**

